



Republika e Kosoves
Republican Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 43/16

Prishtinë, më 29.01.2016, ora 11:15

Ndertesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Adem Grabovci, Labinote Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Jelena Bontic, Bardhyl Meta, Fikrim Damka.

Munguan: Ilir Deda, Enver Hoti, Bali Muharremaj.

Pjesëmarrës të ftuar: Agim Krasniqi-Zëvendës-ministër i Financave, Salvador Elmazi – Drejtor i Deapamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Fjolla Uka- nga KDI, Lumnije Murati nga Zyra e Presidentes, Sadete Zogaj- gaztare nga Kosova Press, Taulant Osmani - gazetar nga Rrokum TV, Rrahman Ramaj - gazetar nga BIRN, Rejhane Zylfiqaj - nga GIZ, Prenk Gjetaj dhe Kushtrim Gara – nga Komisioni Qendror për Personat e Pagjetur - ZKM.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi, Dashuriqe Canolli, Medina Agushi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-060 për mjekësinë ligjore dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;
4. Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2015;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - konstatoi që rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit

Kryetari – në bazë të marrëveshjes, Kosova merr obligime në formë të kredisë në shumë prej 7,900,000SDR apo të konvertuara në euro 6,300,000.

Agim Krasniqi - ne e dijmë që sistemi i arsimit në Kosovë është një nga faktorët kyç që kërkon investime të vazhdueshme për avancim të mëtutjeshëm të sistemit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, gjë që reflekton direkt në avansimin e karrierës për të rinjtë. Kredia në fjalë ka vlerën prej 11 milion dollarëve, është një normë e ulët prej 1.25 %, me një grejs periudhe prej 5 vite dhe me një plan kthimi prej 20 viteve e cila duhet të paguhet me këste, dy herë në vite respektivisht me datën 15 prill dhe 15 tetor. Projekti ka për qëllim forcimin e sistemit të përmirësimit të cilësisë, llogaridhënies efikasitetin e sistemit të arsimit në Republikën e Kosovës që është një nga prioritetet kryesore të Qeverisë.

Kryetari – kërkoj sqarim lidhur me procedurën e negocimit të kredisë deri në dërgimin në Kuvend për ratifikim? Marrëveshja përmban një kredi dhe pavarësisht kushteve, mjetet duhet të kthehen. Ministria e Financave është gjithmonë e involvuar dhe një vlerësim do të duhej të bëhej nëse është e domosdoshme kjo kredi, dhe nëse duhet të bidnemi a është e domosdoshme kredia, se për qfarë qëllime do të përdoren mjetet, sa pritjet të jenë përfitimet dhe a do të investohen mjetet për qëllime kapitale?

Agim Krasniqi – sqaroj se çdo sektor i ka prioritetet e veta. Sektori i arsimit ka prioritetet tjera të cilat nuk janë detyruesisht të ndëlidhura me investimet në kuptimin e infrastrukturës, por në kuptimin e përmirësimit të sistemit të arsimit, të përmirësimit të plan programeve, cilësisë dhe elementeve tjera. Ministria e Arsimit e ka parë të nevojshme që mbi atë buxhet që ka të rregullt ta ketë mbështetjen edhe më të madhe. Mbi këtë bazë është dhënë edhe pëlqimi prej Minsitrisë së Financave.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se komisionit njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-060 për mjekësinë ligjore dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit

Prenc Gjetaj - si Komision për Personat e Zhdukur kemi një propozim që në nenin 15, pika 1.6 fjala „persona të zhdukur“ të zëvendësohet me fjalën „persona të pagjetur“

Kryetari – duke iu referuar parafolësit, theksoi se kjo qështje është përgjegjësi e komisionit funksional. Nuk bie në domenin e komisionit tonë dhe ju sugjerojmë që propozimet tuaja t'i dërgoni tek ai komision. Më pas kryetari theksoi se neni 13 që ka të bëjë me rrezikshmëri dhe orarin në punë është vlerësuar se ka implikime buxhetore shtesë dhe për një vit kërkohen rreth 52,000 euro. Qëllimi i këtij neni është që personat që punojnë në ekzaminim mjeko ligjore të marrin kompenzim shtesë për shkak të natyrës specifike të punës. Ligji për pagat e nëpunësve civil e njih të drejtën e kompenzimit për natyrën specifike të punëve.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr.05/L-060 për mjekësinë ligjore, përmban kosto buxhetore të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, për Projektligjin nr.05/L-060 për mjekësinë ligjore, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2015

Kryetari – plani i punës pasqyron aktivitetet e komisionit për vitin 2015. Kanë mbetur disa aktivitete pa u përfunduar. Grupi punues për mbikëqyrjen e zabtimit të Ligjit për akcizën në produktet e duhanit pritet të vazhdojë punën këtë vit. Ne nuk kemi mundur të kryejmë ligjin për institucionet mikrofinanciare, që konsiderojmë se duhet të vazhdojmë të punojmë me BQK-në, Ministrinë e Financave dhe agjenzinë e ekspertëve. Ka mbetur edhe çështja e ligjit të lojërave të fatit për të cilën konsiderojmë që duhet të bisedojmë me Administratën Tatimore që departamenti të ketë një mbikëqyrje më rigorozë derisa ne nuk bëjmë ndryshimin e ligjit. Këto do të trajtohen në planin e ri të komisionit për vitin 2016.

Safete Hadergjonaj - e kam lexuar raportin dhe ishin të përfshira të gjitha punët dhe aktivitetet të cilat i kemi përfunduar gjatë vitit të kaluar dhe shihet që është bërë një punë mjaftë e mirë dhe e madhe nga ana e komisionit. Ajo çka mendoj duhet të jemi shumë më të përkushtuar, ndoshta të fillojmë me punë që tani, që ti aktivizojmë të dy grupet punuese që i kemi pasur për monitorimin e ligjeve, të cilat nuk kemi arritur t'i përfundojmë në vitin e kaluar, në mënyrë që në planin e punës për këtë vit ne t'i parashohim edhe dy ligje tjera për monitorim.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri miratoi Raportin vjetor të punës së Komisionit për vitin 2015.

5. Të ndryshme

Kryetari – thesoi se për shkak të rrethanave dhe angazhimeve të shumta që ka pasur komisioni, nuk kemi arritur të procedojmë me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, që është propozuar nga një nismë qytetare e nënshkruar nga 13,200 persona. Esenca e ndryshimeve të propozuara me këtë ligj është që të ndryshohet neni 69 i ligjit bazik dhe të njihet e drejtat e kompensimit të dëmeve joekonomike të cilat janë vertetuar nga gjykata në bazë të provave. Është një qështje që e kemi diskutuar gjatë, projektligji është miratuar në lexim të parë në Kuvend, dhe tash jemi në fazën e amendamentimit. Nuk kemi mundur ta marrim prej ministrisë së financave koston buxhetore sepse është shumë vështirë të konstatohet apo llogaritet kjo kosto. Propozojë që unë dhe zëvendë-kryetarja e parë e komisionit të autorizohemi, që bashkarisht me minisitrinë e financave ta shqyrtojnë projektligjin dhe të përgadisim raportin me rekomandime për komision që të marrim një vendim përfundimtar lidhur me këtë qështje dhe të procedojmë më tutje.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni caktojë grupin punues, në përbërje: Naser Osmani dhe Safete Hadergjonaj. Grupi Punues do të shqyrtojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të propozuar nga nisma qytetare dhe do të hartojë raportin me rekomandime për Komisionin.

Mbledhja përfundoi në ora 11:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani